



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002236/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandime për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të abuzuar/dhunuar seksualisht, nisur nga abuzimi e dhunimi i të miturës 15-vjeçare në Tiranë

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE
TË FËMIJËVE**

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

BASHKISË TIRANË

TIRANË

Të nderuar,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, t'ju informoj lidhur me publikimin në mediat *online* të ushtrimit të dhunës seksuale nën presion, ushtruar nga 65-vjeçari me inicialet A.D., ndaj të miturës 15 vjeçare, si dhe regjistrimi e publikimi i videos së veprimeve të turpshme më pas, të kryer nga personi në fjalë.

Nga informacioni i gjeneruar nga mediat online, Policia e Shtetit ka ndaluar 4 persona për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2, i ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve menjëherë, pas informacionit të marrë për një shtetas, 65 vjeç, që kishte abuzuar seksualisht me dhunë një të mitur 15-vjeç, organizuan punën për identifikimin e personit dhe zbardhjen e ngjarjes. Veprimet hetimore të Policisë së Shtetit¹ janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ndaluar, 65-vjeçarin me inicialet A.D. dhe tre shtetas të tjerë me inicialet K.P., 20 vjeç, R.O., 16 vjeç dhe F. B., 15 vjeç, ndaj të cilëve janë konstatuar veprime të veprës penale, kërcënim për publikimin e videos, me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të miturën. E mitura, viktimë e dhunës seksuale është intervistuar në përputhje me legjislacionin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në prezencën e nënës, nga psikologjia, avokatja, dhe oficeri i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim administrimin e dëshmisë së vajzës, si provë që implikon shtetasit e lartpërmendur. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar edhe dy telefonat celularë, në të cilët ndodheshin videot me përmbajtje jo të përshtatshme. Në përfundim, është regjistruar fillimi i hetimit të procedimit penal për shtetasit me inicialet A.D., K.P., R.O. dhe F.B., për veprat penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14 deri në 18 vjeç”, “Shtytja e të miturve në krim” dhe “Vepra të turpshme”, të gjitha kryer në bashkëpunim².

Avokati i Popullit, nisur nga rasti i Kavajës, realizoi një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke analizuar fakte, vlerësuar rrethanat e ngjarjes, deklaratimet e nëpunësve publikë, të mbledhura gjatë hetimit, duke patur parasysh dhe ligjërimin e kahershëm të garantimit të të drejtave të fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Qëllimi i këtij hetimi administrativ konsistonte në parandalimin e këtij fenomeni, duke evidentuar problematikat përkatëse të vprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve përgjegjëse dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse, për marrjen e masave konkrete nga organet e administratës shtetërore, për të bërë të mundur mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme dhune.

Në vijim, më lejoni të parashtroj shqetësimin tonë institucional për çka vërehet edhe në këtë rast, evidentimin e problematikave të ripërsëritura (referuar gjetjeve në raportin sitenzë të Kavajës), si vijon:

¹ Informacion i gjeneruar nga mediat *online*, jo nga hetimet administrative të kryera nga institucioni i Avokatit të Popullit;

² Nenet 100/2, 108 dhe 129, të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i RSH-së”, të ndryshuar

- detyrimin për raportim³, që kanë të gjithë aktorët e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- komunikimi në mënyrë të fragmentarizuar, nga punonjësit e sektorit të arsimit, Policisë së Shtetit, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, bazuar në një qasje individuale, jo funksionale, në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre⁴;
- mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel vendor, e cila vjen, si rrjedhojë e mungesës së informacionit për format, mënyrat e bashkëpunimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e fëmijës;
- mungesa e njohurive dhe informacionit, për faktet apo ndodhitë që përbëjnë vepra penale, sipas legjislacionit penal dhe detyrimit për kallzimin e menjëhershëm të tyre;
- publikimi i rastit nga mediat e shkruara, portalet *on line*, por edhe mediat audiovizive dhe vizive, duke ceduar në identifikimin e viktimës, pasi kanë paraqitur me hollësi detaje të rastit, kanë intervistuar të afërm të fëmijës, kanë publikuar vendqëndrimin e familjes, pamje rreth banesës, zonën administrative, qytetin ku ka ndodhur ngjarja, intervista me vëllain, babain e viktimës, etj.

Publikimi i të dhënave të sipërcituara është në shkelje të parashikimeve ligjore të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar⁵ dhe të Kodit të Transmetimit, një kuadër ligjor që sanksionon të drejtat e fëmijëve për të qenë të mbrojtur, për ruajtjen e të dhënave personale, privatësisë dhe kofidencialitetit. Informacione të tilla të bëra publike, që i bën fëmijët të identifikueshëm në rastet kur ata janë viktimë e një ngjarjeje të rëndë, ndikojnë në riviktimizimin e tyre dhe rehabilitimi bëhet shumë i vështirë më pas.

Për këtë qëllim, ka patur reagim të institucioneve përgjegjëse të administratës shtetërore, konkretisht Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson deklaratën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Autoritetit të Mediave

³ Neni 281, i Kodit të Procedurës Penale, detyron çdo nënpunës publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, kur marrin dijeni për një vepër penale duhet të bëjnë kallëzim me shkrim në prokurori ose te një oficer i policisë gjyqësore.

⁴ Pika 3, e nenit 67, të kreut VI, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është parashikuar detyrim ligjor për raportimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje.

⁵ Në pikën 5, të nenit 33/1, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshur, theksohet se: “...**publikimi i informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë, i dyshuar apo i dënuar, ose zbulimi i ndonjë veçantie të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të një fëmije, ndalohet...**”.

Audiovizive, por nisur nga ripërsëritja e problematikave të konstatuara më lart, (jo vetëm, në rastin e Kavajës)⁶, të publikimit të të dhënave që identifikojnë viktimën, si dhe për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të legjislacionin të sipërcituar, u sugjeron të dyja institucioneve⁷ të bashkëpunojnë ngushtësisht, për të ushtruar kontroll në subjektet përkatëse, në rast të konstatimit të problematikave të evidentuara⁸.

Në vlerësim edhe të komunikimit zyrtar⁹ me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me rekomandimet e adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, për angazhimet konkrete për trajtimin më të gjerë të temës së abuzimit dhe dhunës seksuale në programet mësimore nga institucionet përgjegjëse të hartimit të kurrikulës, si dhe të fuqizimit të kapaciteteve të stafit, për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht në trajnimet për zhvillimin e vazhduar profesional të stafit pedagogjik, institucioni i Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e kahershëm të moszbatimit korrekt dhe brenda afateve kohore të rekomandimeve të adresuara, të cilat do të ndikonin në parandalimin e këtij fenomeni.

Por, shqetësim i kahershëm i ngritur nga institucioni i Avokatit të Popullit është në aspektin e ngritjes e forcimit të kapaciteteve të profesionistëve (punonjës social, psikolog), për identifikimin e fëmijëve të dhunuar në institucionet e edukimit¹⁰. Në vlerësim të zhvillimeve kyçe legjislative, të konkretizuara tashmë në vendin tonë, në drejtim të përmirësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore të strukturave të menaxhimit dhe ofrimit të shërbimeve shoqërore në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, si në shëndetësi, arsim, polici dhe shërbime sociale, janë miratuar ligjet përkatëse për ngritjen e urdhërit të punonjësit social dhe

⁶ Rekomandim i Avokatit të Popullit i datës 2.5.2019, për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive,

⁷ Në pikën 6, të nenit 19, të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet, që AMA, për zbatimin e sanksioneve të përcaktuara në këtë ligj, bashkëpunon me organet e tjera publike, sipas kompetencës së tyre (në rastin në fjalë Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës).

⁸ Në pikën 3, të nenit 19, të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione.

⁹ Shkresa zyrtare me nr.4913/1 prot. datë 28.6.2019, drejtuar për Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

¹⁰ Shërbimi psiko-social në institucionet e edukimit është parashikuar në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ky shërbim ka qenë në rishikim të vazhdueshëm, për sa i përket strukturimit të tij, në raport edhe me detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Kështu, ndryshimet e miratuara me urdhërin nr.150, datë 3.4.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për një ndryshim në urdhrin nr.344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e njësisë së shërbimit social”¹⁰, i cili parashikon një punonjës social ose psikolog për 1800-2300 nxënës në institucionet e arsimit të mesëm të lartë dhe ato të miratuara me urdhërin nr.593, datë 31.12.2019, ku përcaktohet një psikolog/punonjës social për çdo shkollë me 500-700 nxënës dhe 2 psikologë për çdo shkollë me mbi 700 nxënës, edhe pse janë në përputhje me standardet bashkëkohore, sërish konstatohet, që në këtë drejtim ka problematika.

psikologut, të cilat garantojnë standardet etiko-profesionale në ushtrimin e këtyre profesioneve, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të tyre¹¹.

Kjo, e harmonizuar edhe në ligjin e shërbimeve të përkujdesit social¹², ku është përcaktuar akreditimi dhe edukimi i vazhdueshëm për këto profesione. Profesionistët tashmë janë të detyruar që t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional, të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rritin cilësinë e shërbimeve.

Kjo qasje e re kërkon ngritjen e institucioneve përkatëse të parashikuara në legjislacionin e sipërcituar, konkretisht, Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe organizimin e veprimtarive promovuese, ndërmjet profesionistëve, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare të certifikuara në këtë drejtim dhe institucioneve të administratës shtetërore, për të bërë të mundur zbatimin korrekt të legjislacionit dhe informimin e profesionistëve, lidhur me detyrimin e tyre për edukimin në vazhdimësi në garantimin e standardeve më të mira në ushtrimin e profesionit të psikologut dhe punonjësit social.

Duke u kthyer në rastin në fjalë, sjellim në vëmendje, se ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka përcaktuar detyrimin e njësisë bazë të qeverisjes vendore, për garantimin e paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj dhe mjediseve të tyre, si dhe ruajtjen dhe mirëmbajtjen e institucionit arsimor publik.

Në këtë kuptim, shqetësimi ynë institucional shkon kah ruajtjes dhe sigurisë së shkollave me shërbimin me roje private dhe, mënyrës se si rregullohet ky shërbim. Për nga natyra e tij, komplekse dhe delikate, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të jenë tepër rigorozë dhe të kujdesshëm, kur kontraktojnë shërbime të tilla, pasi në këtë rast, interesi më i lartë i fëmijës mbizotëron.

Përzgjedhja e personelit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë, duhet të bazohet në kritere jo vetëm profesionale, por mbi të gjitha mbi kritere që kanë të bëjnë me shfaqjen e vlerave të moralit shoqëror, integritetit dhe personalitetit,

¹¹ Ligji nr.163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.40/2016 “Për Urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”

¹² Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

të cilat me keqardhje konstatojmë, që në më të shumtën e rasteve nuk respektohen.

Sikundër, sërish me keqardhje konstatohet, se shpesh herë për sigurimin e një shërbimi të tillë apo edhe të tjera shërbime bazike në institucionet e edukimit, si ngrohja, etj., të ardhurat gjenerohen nga pagesat e prindërve të nxënësve.

Për sa më sipër, kërkojmë nga institucionet përgjegjëse shqyrtimin dhe trajtimin me seriozitet dhe përgjegjshmëri të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe zbatimin korrekt të masave të parashikuara nga vetë institucionet, të cilat do të bëjnë të mundur funksionimin e të gjitha hallkave zinxhir të mekanizmave të shtetërorë përgjegjës për sitemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi dhe eliminimin në ripërsëritje të problematikave të evidentuara.

Abuzimi seksual i fëmijëve shfrytëzon dhe degradon fëmijët dhe mund të shkaktojë dëme serioze në zhvillimin njohës, shoqëror, psiko-social dhe emocional të një fëmije. Si shoqëri, ne kemi përgjegjësi kolektive për të parandaluar abuzimin seksual të fëmijëve. Për t'a arritur këtë, në njërin anë, është detyrë e institucioneve shtetërore përgjegjëse, për të ndërmarrë dhe mbështetur shërbime dhe politika, që rrisin zhvillimin, shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve. Përpos, detyrës nga ana tjetër, që kemi ne, si institucione kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti, e shoqëria civile, për të advokuar për politika dhe programe, për të ndihmuar në plotësimin e nevojave themelore të fëmijëve, në përputhje me nevojat e moshës dhe familjeve të tyre. Në fakt, është detyrë parësore e aktorëve kyç të sistemit të integruar të mbrojtjes, mbështetja e kërkimeve shkencore, për hartimin e studimeve për analizimin e shkaqeve që përbëjnë faktorë të rrishtit dhe nxisin dhunën si dukuri në të gjitha format e saj, sikundër është parësore edhe gjetja e mekanizmave efikasë në funksion të parandalimit të kësaj dukurie.

Në këtë kuptim, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, për të mbrojtur fëmijën ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masës disiplinore, për drejtuesin e institucionit të edukimit, ku vazhdon procesin e edukimit e mitura, viktimë e dhunës seksuale, për shkarkimin si drejtues, për paaftësi në organizimin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimin me të gjithë faktorët, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret institucionale, që burojnë prej tyre.
- Marrjen e masave nga institucionet edukative e më gjerë, për të punuar më shumë me fëmijët dhe stafin pedagogjik, në drejtim të edukimit, ndërgjegjësimit, dhe informimit të tyre, lidhur me mbrojtjen nga dhuna dhe çdo formë e saj, sidomos asaj seksuale, si dhe të promovojnë praktika të mira pune për vendosjen e një komunikimi të sigurtë e të hapur, në mënyrë që këto çështje të mos përbëjnë më tabu.
- Marrjen e masave konkrete nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për monitorimin në vijëmbasi të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, pjesë e sitemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, sipas legjislacionit në fuqi dhe, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative “*de facto*”, në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.
- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të bërë të mundur edukimin në vazhdimësi të profesionistëve që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.
- Marrjen e masave nga AMA, për ushtrimin e kontrollit ndaj veprimtarisë së mediave audiovizive për rastin në fjalë, të cilat kanë shkelur legjislacionin në fuqi, për sa i përket mënyrës se si duhet t’i qasen dhe të trajtojnë çështje të abuzimit/dhunës seksuale tek të miturit.
- Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë, për vendosjen e kriterëve specifike në përzgjedhjen e personelit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë në shkolla, të cilat duhet të bazohen në kriterë jo vetëm profesionale, por mbi të gjitha që kanë të bëjnë me shfaqjen e vlerave të moralit shoqëror, integritetit dhe personalitetit.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA